

## NJOFTIM

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë shpall njoftimin për konkurim të hapur, për vendet e lira të punës:

*“5 (pesë) Personel akademik me angazhim kohë të pjesshme, për vitin akademik 2024-2025, pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore.*

### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Pedagog me angazhim me kohë të pjesshme
- Mbështetje për nevojat e Departamentit dhe Fakultetit

### **Kriteret e punësimit për 4 (katër) pedagogë me kohë të pjesshme në Departamentin e Shkencave Kompjuterike janë si më poshtë:**

1. Të ketë përfunduar Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve në degën informatikë, shkenca kompjuterike, teknologji informacioni ose tituj të tjerë të ngjashëm në fushën e shkencave kompjuterike në sistemin me kohë të plotë, të fituara në IAL në Shqipëri ose në universitetet të huaja.
2. Preferohet mesatarja e notave ne te dy nivelet mbi 7.5. Por, ne kushtet e mungesës së aplikantëve që plotësojnë këtë kriter, do të aplikohet renditja në rendin zbritës sipas mesatares për të gjithë aplikantët deri në përmbushjen e nevojave të departamentit.

### **Për 1 personel akademik me kohë të pjesshme, të cilët do të mbulojnë lëndë në programet e ciklit të dytë të studimit kriteret bazë janë si më poshtë:**

- 1) Të zotërojë gradën shkencore “Doktor i shkencave” në fushën e shkencave kompjuterike, inxhinieri informatike, teknologji informacioni e të ngjashme me to.

### **Kritere të tjera**

1. Të zotërojë aftësi profesionale për vendin e punës.
2. Botime më revista shkencore brenda dhe jashtë vendit.
3. Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit.
4. Njohuri të gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian.

### **Kritere të përgjithshme që duhet të plotësojë/në kandidati/ët**

- Të jetë shtetas/e shqiptar/e.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;

- Të ketë aftësi të mira komunikuese etiko-profesionale, të bashkëpunimit dhe të punës në grup me kolegët dhe eprorët;
- Të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, të certifikuara sipas testeve të njohura nga MAS. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje si dhe të mos jetë person nën hetim për vepra të rënda penale;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna”;
- Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Isamil Qemali” Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe autoriteteve/organeve drejtuese të saj, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

Skema e vlerësimit për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, që do të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike do të jetë si më poshtë:

Vlerësimi i kandidatëve konkurues përfshin dy faza:

- Vlerësimi i dosjes, parashikon verifikimin e dokumentave nëse kandidatët plotësojnë kërkesat për vendin vakant, vlerësimin e edukimit (30 pikë), përvojës në mësimdhënie dhe kërkimi shkencor (20 pikë), trajnimet dhe kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe gjuhë e huaj (10 pikë), dhe vlerësimet pozitive në punë (10 pikë).
- 30 pikë intervista e strukturuar me gojë, ku vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe formimi i tyre.

## **PIKËZIMI I KRITEREVE**

**1. Vlerësimi i edukimit: Pikëzimi për mesataren e notave fillon nga mesatarja bazë e vendosur si kriter:**

- |                                                                |                                                 |
|----------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|
| - Për të dyja ciklet e studimit mesatarja e vendosur si kriter | 0.50 pikë për çdo 1/10 e notës duke filluar nga |
| - Doktoraturë e përfunduar                                     | 20 pikë                                         |
| - Profesor i Asociuar                                          | 25 pikë                                         |
| - Profesor                                                     | 30 pikë                                         |

## 2. Aktivitet shkencor në 5 vitet e fundit (deri në 10 pikë)

Artikuj të botuar në revista me bord editorial dhe ISBN	0.5 pikë për çdo artikull
Artikuj të botuar në revista me faktor impakti	1 pikë për çdo artikull
Pjesëmarrje në konferenca kombëtare ku punimi është botuar në proceedings me bord editorial, me ISBN.	0.5 pikë për çdo konferencë
Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare në vendet e BE, ku punimi është botuar në proceedings me bord editorail, me ISBN.	1 pikë për çdo konferencë
Eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë	0.5 pikë për çdo vit (deri në 20 vjet).
Gjuhë e Huaj	4 pikë
Trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse të njohura kombëtarisht ose ndërkombëtarisht	6 pikë
Vlerësime pozitive në punë	10 pikë

### Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë

- Aftësitë komunikuese, bashkëpunuese etj.

### Dokumentacioni i kërkuar

- Letër interesi për pozicionin (formulari i aplikimit i plotësuar nga aplikanti, gjendet në adresën [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)),
- Jetëshkrim/Curriculum Vitae,
- Diploma/t universitare (kopje te noterizuara),
- Lista e notave të studimeve universitare (origjinal),
- Tituj akademik ose grada shkencore (kopje te noterizuara),
- Dëshmi e kualifikimeve, trajnimeve apo specializimeve (kopje te noterizuara),
- Artikuj të botuar, projekte shkencore, etj,
- Libreza e punës ose vërtetim zyrtar për periudhën kohore të punësimit nga organi tatimor (origjinal ose kopje të noterizuar),
- Rekomandime nga profesor/profesor i asociuar ose/dhe punëdhënësi i fundit,
- Referenca që provojnë vlerësimet pozitive në punë,
- Dëshmi e njohjes e gjuhës së huaj (origjinal ose kopje të noterizuar),
- Dëshmi e njohjes se kompjuterit (origjinal ose kopje të noterizuar)
- Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal),
- Vendim i gjendjes gjyqësore (dokument i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku kandidati ka vendbanimin),

- Letërnjoftimi ID (fotokopje)

*Kandidatët të cilët dorëzojnë dokumentacion të pa noterizuar, ose kanë mungesë në dokumentacion nuk do të merren në shqyrtim nga komisioni.*

*Diplomat, certifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me certifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*

### **Mënyra e aplikimit**

Dokumentat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën:

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.  
Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës.

#### **Aplikim për punësim/pozicioni i punës:**

*“Personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2024-2025, pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore”.*

Lagja: “Pavarsia”, Rr: “Kosova” 9400 Vlorë, Shqipëri

### **Afati për aplikim**

✓ Afati për të aplikuar është 10 ditë kalendarike. Ky afat fillon nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të internetit të UV-së. (njoftimi u publikua në datën 17.02.2025 dhe afati përfundon në datën 26.02.2025).

✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 26.02.2025 do t’i kthehet aplikantit pa veprime.

### **Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

Komunikimi dhe njoftimi i kandidatëve do të mundësohet nga zyra e burimeve njerëzore të UV-së nëpërmjet postës elektronike.